



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT ANALIZË VJETORE - 2024

1. Arritjet kryesore

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit gjatë vitit 2024 ka realizuar plotësimin e detyrave të lëna nga auditet e vlerësuesve të CEN&CENELEC, të cilat janë elementë kyç drejt anëtarësimit me të drejta të plota të DPS në dy Komitetet Evropiane të Standardizimit CEN dhe CENELEC. Plotësimin e këtyre detyrave DPS e ka raportuar edhe në takimin e nënkomitetit (Tetor 2024) Shqipëri – BE, mbajtur në Tetor 2024 në Bruksel. Përafrimi në fushën e standardizimit, duke konsideruar edhe legjislacionin, i cili është në përputhje të plotë me *acquis* në këtë fushë deri në anëtarësimin e plotë të saj në CEN&CENELEC, si një parakusht ky për anëtarësimin e vendit në BE, kërkon më shumë punë, angazhim dhe mbështetje për DPS.

Gjithashtu, DPS ka realizuar objektivat si vijon:

- Përafrimi i legjislacionit – iniciativat legislative/aktet nënligjore

Përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC) është ndër objektivat kryesorë të DPS. Nga auditet e kryera nga vlerësues të pavarur të CEN&CENELEC, si dhe takimet me ekspertë të BE gjatë procesit *screening* rezultojnë se aktualisht paketa ligjore e standardizimit është në përputhje të plotë me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ato ndërkombëtare (ISO dhe IEC).

Gjatë vitit 2024 DPS nuk ka patur iniciativa të reja ligjore e nënligjore për fushën e saj të përgjegjësisë dhe nuk parashikon edhe për 2025.

- Databaza e standardeve

Në kuadër të projektit *Global Quality and Standards Programme* (GQSP) në bashkëpunim të ngushtë me AKSHI, DPS ka realizuar përmirësimin dhe përditësimin e databazës së standardeve, përmirësimi i të cilës përmbush realizimin e detyrave të lëna nga auditet kundrejt anëtarësimit me të drejta të plota të DPS në CEN&CENELEC.

Në vijim të kësaj pune janë organizuar një numër takimesh dhe trajnimesh *online* dhe në zyrat e DPS. Gjithsej janë realizuar 4 trajnime gjatë Dhjetorit 2024. Gjithashtu, janë kryer trajnime të stafit për standardin ISO 9001, sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe lidhjen e standardit dhe mirëmbajtjes së certifikimit sipas këtij standardi me kreretet për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC – Guida 22/2021 e CEN&CENELEC.

Përmirësimet dhe ndërhyrjet e kryera në databazën e standardeve përkohësisht edhe me zhvillimet lidhur me derregullimin e shërbimeve të ndërmarra nga Qeveria.

- **Forcimi i kapaciteteve administrative**

Forcimi i kapaciteteve të stafit është gjithmonë në vëmendjen e DPS. Gjatë vitit 2024 janë realizuar një numër trajnimesh, të tilla si:

- trajnim disa ditor i stafit të DPS-së, në lidhje me përfitimet e zbatimit të standardit ISO 9001 dhe lidhja e tij me kriteret për anëtarësim në CEN&CENELEC - Kuptimi i certifikimit sipas ISO 9001 dhe ndërthurja e kriterëve të Guidës 22/2021 të CEN&CENELEC në SMC;
 - disa trajnime *online* të realizuara nga ASPA, ku stafi i DPS ka marrë pjesë, vecanërisht stafi i ri;
 - Praktikant më të mira në sigurinë kibernetike dhe higjenën kibernetike;
 - Përdorimi i databazës për proceset e adoptimit, shitjes dhe publikimit të standardeve;
 - menaxhimi i faqes së internetit të DPS;
 - praktikant e mira të standardizimit
- **Procesi i integritimit - Anëtarësimi me të drejta të plota në CEN&CENELEC**

Lidhur me proceset e integritimit – *screening* për Kapitujt 1, 20 dhe 28 të *acquis*, DPS ka prezantuar situatën e standardizimit në vend sa i përket rolit të standardeve në fushat e mbuluara nga këto kapituj, si dhe planet/afatet dhe mënyrat e realizimit në të ardhmen të plotësimit të kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC.

Fusha e standardizimit, për të tre kapitujt e përmendur më lart, duke konsideruar edhe legjislacionin, i cili është në përputhje të plotë me *acquis* në këtë fushë, është konsideruar në përputhje dhe nuk krijon pengesa në tregti, por kërkohet më shumë suport për DPS deri në plotësimin e kriterëve dhe anëtarësimin e plotë të saj në dy organizmat evropiane të standardizimit CEN&CENELEC, si një parakusht ky për anëtarësimin e vendit në BE dhe progresin që kërkohet për Planin e Rritjes (*Growth Plan*).

Sa i përket anëtarësimit me të drejta të plota në CEN&CENELEC, DPS ka punuar për plotësimin e kriterëve dhe rekomandimeve për përmirësime, në zbatim të planveprimit që u la nga vlerësuesit e pavarur të CEN&CENELEC. Nga detyrat e parealizuara nga plani i veprimit më kryesoret janë përmirësimet në databazën e standardeve dhe rritja e numrit të stafit të DPS. Periudha e evidentimit përkundrejt plotësimit të kriterëve të anëtarësimit është realizuar brenda Dhjetorit 2024, sic ishte e dakordësuar më parë me CEN&CENELEC, si dhe me Komisionin Evropian në takimet e Nën-Komitetit të BE - Shqipëri për Tregëtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet.

DPS është në komunikim të vazhdueshëm me strukturat përkatëse të CEN&CENELEC për vazhdimin e procesit të anëtarësimit në këto Komitete dhe gjatë Janarit 2025 priten komunikime dhe vendime nga Komiteti për Anëtarësim i CEN&CENELEC (MRMC).

- Të dhëna statistikore krahasuar me vitin 2021, 2022, 2023 - Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)

Gjatë vitit 2024 janë adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH) 2,299 Standarde Evropiane dhe ndërkombëtare, duke përfshirë standardet e harmonizuara, amendamentet dhe dokumentet e standardizimit, nga të cilat të specifikuara sipas origjinës janë:

- 793 CEN;
- 394 CENELEC;
- 667 ETSI;
- 293 ISO;
- 152 IEC.

Totali i adoptimeve krahasuar me vitet paraardhëse është si vijon:

Viti	2021	2022	2023	2024
Totali i adoptimeve	2,225	1,828	1,798	2,299

Sa i përket numrit të standardeve të adoptuara sipas fushave, mbizotërojnë standardet e fushave të inxhinierisë civile të publikuara nga CEN dhe ISO.

- Promovimi dhe publikimet - Transparenca

Gjatë kësaj periudhe janë përkthyer/përgatitur dhe publikuar në faqen e web-it dhe në rrjetet sociale të DPS mbi 43 artikuj dhe 115 ekstrakte standardesh të fushave, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të DPS dhe në rrjetet e saj sociale. Publikimet kryesisht i përkasin fushave si vijon:

- Metoda provash për laboratorët
- Inteligjenca artificiale
- Pajisje elektroshtëpiake
- Mobilje
- Mjekësia
- Materiale ndërtimi
- Trupa dhe lëndë druri
- Produkte nafte, lubrifikantë
- Sigurimi i cilësisë dhe përgjegjësia sociale
- Siguria e lodrave
- Kaldaja avulli, bombola gazi
- Teknologjia e komunikimit dhe informacionit
- Pajisje inxhinierike
- Pajisje mjekësore
- Produkte ushqimore
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës
- Sporti
- Mjekësia
- Siguria ushqimore
- Siguria e lodrave
- Artikuj për fëmijë
- Pajisje mbrojtëse personale
- Lëndë djegëse
- Artikuj për fëmijë
- Dokumentacioni dhe informacioni

Janë publikuar njoftimet dhe vendimet e marra nga mbledhjet e bordit teknik dhe të Bordit Drejtues të DPS.

Në kuadër të transparencës dhe informimit janë publikuar katër Buletine dhe shtojca e Buletinit 97/1, përkatësisht Buletini Nr. 97, Nr.98, Buletini Nr.99 dhe Buletini Nr.100, sic jepen në tabelën më poshtë:

Buletine informative			
No	Periudha	Përmbajtja e informacionit	Komente
97	Tetor – Dhjetor 2023	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	Buletini për këtë periudhë publikohet në ditët e para të janarit të vitit në vijim. Shtojca e tij publikohet pas mbledhjes së Bordit Teknik për miratimin e Programit të Punës me Standarde.
97/1	Janar – Dhjetor 2024/Programi i punës për adoptimin e standardeve	Programi i punës i vitit 2024 me draft standardet shqiptare dhe draft dokumentet shqiptare për opinionin publik.	
98	Janar – Mars 2024	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
99	Pril – Qershor 2024	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
100	Korrik - Shtator 2024	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	

Notifikime – Zbatimi i VKM 789/2009 “Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjeve për barrierat Teknike në Tregti dhe të Masave Sanitare dhe Fitosanitare të Organizatës Botërore të Tregtisë”

Janë bërë dy (2) notifikime në Sekretariatit e OBT dhe në CEFTA, nëpërmjet platformave *eping* dhe *CEFTA Transparency Pack*, si dhe janë përcjellë në institucionet përkatëse – kryesisht në ISHMT – kërkesat e ardhura nga shtetet anëtare të OBT lidhur me rregullat/procedurat dhe aktet ligjore në fuqi për vendosjen në treg të disa produkteve, kryesisht të disa materialeve elektrike.

Janë bërë rregullisht edhe notifikimet përkatëse në CEN dhe CENELEC për të gjitha adoptimet e standardeve europiane si standarde shqiptare, nëpërmjet platformës *iProjex*. Puna në Njoftimet INFOPRO ka vazhduar dhe projekt-standardet janë njoftuar rregullisht.

Është tejkaluar plani i shitjeve të standardeve në rreth 33% (754 nga 512 që ishte plani) më shumë standarde Shqiptare të shitura. Krahasuar me vitin 2021, 2022 dhe 2023 vërehet se është rritur kërkesa për standarde nga sektori privat.

Standardet më të shitura janë të fushave të ndërtimit dhe TIC:

- Beton dhe produkte që lidhen me të;
- Automatizimi, menaxhimi dhe aksesorët në ndërtim
- Sisteme të përpunimit të informacionit;

- Marrëveshjet e bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit

Në Dhjetor 2024 DPS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT), si dhe ka marrëveshje bashkëpunimi pothuaj me të gjitha organet kombëtare të standardizimit në vendet e Rajonit.

Gjithashtu, bazuar në Urdhërin e përbashkët të MEKI dhe MIE, DPS është pjesë e grupit të punës për përafrimin e rregullores 2011/305/EU, për përcaktimin e kushteve për vendosjen dhe vënien në dispozicion të produkteve të ndërtimit, si dhe eliminimin e barrierave teknike në tregti.

- Realizimi i buxhetit për vitin 2024

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, kreut VIII, nenit 65 "Monitorimi",

Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qëndrore" për periudhën Janar – Prill 2024 janë planifikuar dhe shpenzuar fondet buxhetore të ndara në dy periudha.

Referuar shkresës së Minsitrisë së Financave Nr. 2917/1 Prot. datë 12.03.2024 "Kthim përgjigje" kodi i Drejtorise se Standardizimi ishte 1010281 deri ne 31 Mars 2024 dhe behët 101211 nga Prilli 2024.

Akordimi i fondeve buxhetore për vitin 2024 dhe realizimi Janar - Dhjetor 2024 jepen në Tabelën si vijon:

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN BUXHETI 2024	FAKT JANAR- MARS 2024 (kodi 1010281)	FAKT DHJETOR 2024 (kodi 101211)	REALIZIMI 12- MUJORI 2024
1	Paga	23,000	4,871	16,811	21,682
2	Sigurime shoqërore	4,000	754	2,682	3,436
3	Mallra e shërbime të tjera	3,500	381	2060	2,441
4	Transferta Korente të Huaja	14,000	4,169	3,479	7,648
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	344	4	273	277
6	Investime	1,000		792	792
	Totali	42,344	10,179	26,097	36,276

Gjatë vitit 2024 janë realizuar procedurat e prokurimit sipas tabelës si vijon:

Regjistri i realizimeve të prokurimit publik

Për vitin: 2024

Autoriteti Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve

Nr.	Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Lloji i Procedures se Prokurimit	Vlera e kontratës (pa TVSH)	Data e zhvillimit te procedure s se prokurimit	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik	Data e lidhjes se kontrates	Data e perfundimit kontrates
1	"Blerje materiale promovimi dhe marketingu"	100,000	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	83,240.00		Altin Ruço	K91615034G		
2	"Blerje mobilje orendi zyre për DPS"	833,333	Small Value	243,390.00	03/12/2024 11:00 AM	2R-Group	L57104903Q	Kontrata Nr. 384/2 Prot. Date 06.12.2024	10.12.2024
3	Blerje Biletash për Transport Ndërkombëtar	1,500,000	Purchase Tickets	48,500.00	03/06/2024 12:00 PM	SPIRIT TRAVEL & TOURS	L32403002P		
				42,000.00	06/08/2024 12:00 PM	GOLDEN TRAVEL	L31310007Q		
				85,850.00	18/10/2024 11:30 AM	AMADEUS TRAWELL AND TOURS	K31528061N		
				50,600.00	08/11/2024 11:30 AM	AMADEUS TRAWELL AND TOURS	K31528061N		
				118,000.00	16/09/2024 12:00 PM	AMADEUS TRAWELL AND TOURS	K31528061N		
				41,310.00	24/09/2024 12:00 PM	AMADEUS TRAWELL AND TOURS	K31528061N		
				100,980.00	24/06/2024 11:30 AM	AMADEUS TRAWELL AND TOURS	K31528061N		
4	Blerje materiale kancelarie	90,000	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	83,158.00		EURO OFFICE	K31803032W		
5	Blerje Materiale Pastrimi	100,000	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	49,625.00		S.L.M.	K71605001B		
6	Blerje pajisje elektronike (TIK)	833,333	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	416,666.50	07/11/2024 11:00 AM	INSTANT.AL	L81506043D	Kontrate Nr. 370/2 Prot. Date 13.11.24	14.11.2024
7	Blerje Tonera për printer për nevojat e DPS-së"	80,000	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	72,500.00		EURO OFFICE	K31803032W		
8	Tabela informuese, treguese të insitucionit dhe badge për stafin në	60,000	Blerje e Vogel nen 100,000 leke	29,000.00		GRAPHIC LINE - 01	K31722069H		

- Objektivat strategjike zbatimi dhe monitorimi i tyre, strategjite e reja, strategjite ndërsektoriale

Objektivi strategjik për DPS është realizimi i anëtarësimit me të drejta të plota në dy Komitetet Evropiane të Standardizimit (CEN dhe CENELEC). Ky objektivi është shprehur edhe në strategjinë sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut 2025-2030, ku fusha e standardizimit është pjesë e kësaj strategjie. Realizimi i këtij objektivi strategjik kërkon realizimin e disa objektivave të tjerë, të cilët ndahen në afatshkurtër dhe në afatgjatë.

Objektivat afatshkurtër:

1. Përafrimi i acquis/legjisacionit për fushën e standardizimit, sipas nevojës;
2. Rregullimi i të gjitha procedurave dhe dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) në DPS të ndërthurur dhe sipas kriterëve për anëtarësim;
3. Mirëmbajtja për një funksionim adekuat i databazës së standardeve;
4. Trajnimi i stafit me praktikën më të mira të standardizimit;
5. Komunikimi me strukturat përkatëse të CEN&CENELEC sa i përket anëtarësimit të DPS dhe diskutimi i çdo çështjeje me rëndësi për këtë;
6. Zbatimi korrekt i marrëveshjeve të bashkëpunimit me CEN&CENELEC dhe jo vetëm;
7. Adoptimi i standardeve evropiane si Standarde Shqiptare, përfshirë këtu edhe ato të harmonizuara në zbatim të legjisacionit/direktivave;
8. Plotësimi i të gjitha kriterëve për anëtarësim sipas Guidës 22 të CEN&CENELEC.

Objektivat afatshgjatë:

1. Mirëmbajtja e SMC dhe e certifikatës së këtij sistemi sipas standardit ISO 9001 dhe kriterëve të anëtarësimit, në mënyrë që të sigurohet vlerësim pozitiv edhe gjatë auditeve të CEN&CENELEC, të cilat janë periodike (çdo vit) edhe mbas anëtarësimit;
2. Plotësimi në vazhdimësi i kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e anëtarësimit në këto organizma.
3. Ndjekja e ritmit të adoptimeve të standardeve evropiane si Standarde Shqiptare;
4. Përkthimi në shqip i atyre standardeve evropiane dhe/ose ndërkombëtare më të domosdoshme për ekonominë;
5. Pjesëmarrja aktive në punën evropiane të standardeve;
6. Trajnim i vazhdueshëm i stafit, për të bërë të mundur realizimin e punës sipas praktikave më të mira në fushën e standardizimit;
7. Transpozimi i plotë i Direktivës së BE 1535/2015 “Për informimin në fushën e rregullave teknike dhe të rregullave për shërbimet e shoqërisë së informacionit;
8. Trajnim i kryetarëve të Komiteteve Teknike të DPS për pjesëmarrjen në punën evropiane e ndërkombëtare për hartimin dhe miratimin e standardeve.